**Titulli i lëndës: Letërsia gjermane prej Ekspresionizmit deri te 1945**

| **Informatat themelore për lëndën** | |
|---|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Filologjisë: Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë gjermane |
| Titulli i lëndës: | Letërsia gjermane prej Ekspresionizmit deri te Rajhu i Tretë |
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi i lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | viti i IV, semestri i VII-të |
| Numri i orëve në javë: | 3+2 |
| Kreditë ECTS: | 6 |
| Koha / Vendi: | |
| Mësimdhënësi: | Prof. Dr. Naser Mrasori |
| Të dhënat kontaktuese: | Naser.Mrasori@uni-pr.edu |
| **Përshkrimi i lëndës:** | Lënda "Letërsia gjermane prej Ekspresionizmit deri te 1945, ka për qëllim t'i njoh studentët me: karakteristika e përgjithshme, me krijimtarinë, gjinitë letrare si edhe përfaqësuesit kryesorë të Ekspresionizmit, Letërsinë e viteve të njëzeta, Letërsinë e Republikës së Vajmarit, Letërsinë e periudhës së Rajhut të Tretë si edhe Letërsinë në Ekzil. Në këtë kurs është paraparë edhe leximi dhe analiza e disa veprave të autorëve nga kjo periudhë, si psh: Ben, Trakl, Döblin, Heim, Shüler, Zweig, Mann, Hesse, Seghers, Schnitzler, Kästner, Kafka, Musil, Rot, Werfel, Rilke, Brecht, Canetti etj. |

| | |
|---|---|
| **Qëllimet e lëndës:** | Lënda ka për qëllim të ofroj njohuri të mjaftueshme për studentët e këtij niveli, të cilët pas pjesmarrjes në këtë kurs, duhet të njohin krarakteristikat dhe autorët kryesorë të kësaj periudhe të letërsisë gjermane, si dhe të kenë njohuri të mjaftueshme analitike dhe intepretuese me veprat, temat dhe autorët më të njohur të kësaj periudhe, me qëllim për të kuptuar mënyrën dhe objektin e krijimatarisë letrare të gjysmës së parë të shekullit 20. |

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e pritshme të nxënies:** | Në fund të këtij kursi studentët duhet të kenë njohur të mjaftueshme:<br>• për konceptet themelore të letërsisë të kësaj periudhe;<br>• për rrjedhën historike dhe ngjarjet me të rendësishme pas vitit 1900;<br>• për temat dhe gjinit kryesore të letërsisë së kësaj periudhe;<br>• për Ekspresionizmi në përgjithësi<br>• për Letërsisë të viteve të njëzeta,<br>• për Letërsinë e Republikës së Vajmarit,<br>• për Letërsinë e periudhës së Rajhut të Tretë<br>si edhe për Letërsinë në Ekzil |

| .Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit) | | |
|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** |
| Ligjërata | 3 | 15 |
| Ushtrime | 2 | 15 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 10 min | 15 |
| Kollokviume, seminare | 5 | 2 |
| Detyra të shtëpisë | 3 | 15 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 4 | 15 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 5 | 6 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz,provim final) | 1 | 2 |
| Projektet, Prezantimet ,etj | 30 min | 1 |
| **Totali** | | **150:25 = 6<br>6 ECTS** |

| | |
|---|---|
| Metodat e mësimdhënies: | Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimit duke përdorur materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentësh në një projekt (punë e pavarur), detyrë shtëpie individuale. |
| Metodat e vlerësimit: | Vlerësimi është paraparë të bëhët sipas statutit dhe rregulloreve të Universitetit të Prishtinës, provimi organizohet me shkrim dhe me gojë. Duke pasur parasysh edhe punën dhe angazhimin e studentëve gjatë vitit akademik si p.sh. pjesëmarrja në ligjerata, angazhimi, punimet seminarike, testet, referimet, diskutimet, etj. Rezultati përfundmintar llogaritet si në vijim:<br>- Pjesëmarja aktive, përfundimi i seminareve dhe detyrave në kohë dhe angazhimi në Ligjërata (20%)<br>- Testi i parë (15 %)<br>- Testi i dytë (15 %)<br>- Provimi përfundimtar (me shkrim/me gojë) (50%) |
| Literatura primare: | **<u>Literatura bazë:</u>**<br>1. Barner, Wilfried: Geschichte der deutschen Literatur von 1945 bis |

| | |
|---|---|
| | zur Gegenëart.Verlag C.H.Beck Muenchen 1994. ISBN3 406 38660 1<br>2. Heinz Forster & Paul Rieger: Deutsche Literaturgeschichte. Band 11&12.dtv Muenchen 2002.<br>3. Joachim Bark, Dietrich Steinbach, Hildegard Wittenberg Hrsg: Epochen der deutschen Literatur (Gesamtasugabe) Klett,Stuttgart 1989.<br>4. Joachim Bark,Dietrich Steinbach, Hildegard Wittenberg Hrsg .Geschichte der deutschen Literatur von 1945 bis zur Gegnwart.Klett, Stuttgart .<br>5. Gerald Reiner, Norbert Kern, Eva Rainer: Geschichte der deutschsprachigen Literatur. Veritas Verlag Linz. 4 Auflage 2004.<br>6. Ingo Leiss und Hermann Stadtler. Deutsche Literaturgeschichte. Band 8 & 9. dtv. München 1999.<br>7. Expressionismus – Der Kampf um eine literarische Bewegung.dtv. München, 1965. |
| Literatura shtesë: | 1. H.Brackert, J.Stückrath: Literaturwissenschaft Ein Grundkurs/rororo, Hamburg, 2001.<br>2. Winfried Freund: Deutsche Literatur. Dumont, Köln, 2002.<br>3. Host Denkler. Drama des Expressionismus. W. Fink Verlag. München 1979. |

| **Hartimi i planit mësimor** | |
|---|---|
| ***Java e parë*** | Expresionizmi si periudhë letrare dhe artistike,<br>Avantgarda dhe Ekspresionizmi, |
| ***Java e dytë*** | Ekspresionizmi – Modë, Stil dhe Pikëpamje |
| ***Java e tretë*** | Epika, Lirika dhe Drama e Ekspresionizmit |
| ***Java e katërt*** | Deformimi, Grotesku, dhe Absurditeti i jetës. |
| ***Java e pestë*** | Lufta e Parë Botërore,<br>Njohuritë e reja, mediat e reja dhe letërsia e re |
| ***Java e gjashtë*** | DADA-izmi, Anti-Arti |
| ***Java e shtatë*** | Krizat në narracion dhe Kriza e narracionit, kriza e tregimit realist, fantastikja dhe grotesku, shumëkuptimësia e narracionit |
| ***Java e tetë*** | Kubizmi, Surealizmi dhe Futurizmi |
| ***Java e nëntë*** | Tëhuajsimi dhe efekti i tëhuajsimit në letërsinë e ekspresionizmit |

| | |
|---|---|
| ***Java e dhjetë*** | Romani dhe reportazhi si krijime letrare kryesore, romani në mërgim dhe për mërgim |
| ***Java e njëmbedhjetë*** | Vitet e arta, vitet e 20-ta,<br>Realizmi në letërsinë e viteve të 20-ta. |
| ***Java e dymbëdhjetë*** | Objektiviteti i ri (Neue Sachlichkeit) |
| ***Java e trembëdhjetë*** | Letërsia e punëtorëve (Arbeterliteratur), letërsia proletare, kultura e re e proletariatit, Agjitacioni dhe propaganda (Agit-Prop) |
| ***Java e katërmbëdhjetë*** | Letërsia në ekzil dhe migracioni i brendshëm, autoret, temat dhe qendrat e ekzilit të autorëve gjerman |

**Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Mësimi zhvillohet me ligjërata, ushtrime dhe me shpjegime përkatëse për rrjedhën historike dhe letrare të letërsisë së këtyre periudhave. Në fillim do të jepen informacione të përgjithshme në mënyrë kronologjike, si dhe rrjedhën e krijimtarisë letrare. Në vazhdimësi diskutohen shembuj nga krijimtaria e autorëve me në zë të kësaj periudhe, për gjinitë e ndryshme letrare si dhe komentohen temat dhe ngjarjet kryesore. Gjatë realizimit të këtij kursi, shfrytëzohet literaturë e pasur dhe zbatohet metoda ndërvepruese.

Përmes këtij kursi studentët pritet të thellojnë dijet përmes metodadave dhe politikave të reja akademike, sudentët duhet të vijnë me kohë në sallën e mësimit, atyre u kërkohet të jenë aktiv në pjesëmarrje, gjatë ligjëratave, në referime, diskutime, si dhe në punë seminarike.

10.10.24.MrN